

KOSOVARJA

Ballina: Edona Mirakaj

Nazmi Krasniqi
u lind në qeli
dhe vdiq në qeli

Kush janë
“kazanovat”
e Kosovës

**EDONA
MIRAKAJ,**
*themeluesja
e Bestfertility*

Shqipe
Sylejmani,
shkrimtarja
unike

Sot
martohen shpejt
e ndahen
edhe më shpejt

Gruan
e dashnorit tim
e bëra mike

UB në Gjermani
takime me bizneset
nga Kosova

remos

DENTIFIX

eurokoha

BREZOVICA
WITKAM

allüre

UB
UNION BUSINESS

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

KENOA
CENTER

SHERWOOD

Banaderm

MARITIM
CIMA

Edona Mirakaj, themeluesja e Bestfertility, një hapësirëtare në menaxhimin e dëshirës për fëmijë



Me pasion, ekspertizë dhe inovacion drejt realizimit të dëshirës më të madhe. Një shikim në botën e Bestfertility...

Me vite shumë çifte kanë luftuar me dëshirën e pambushur për fëmijë. Në këtë kohë e shpresa të humbura dhe frustrim, Edona Mirakaj është pranë tyre si themeluese e Bestfertility.

Rruga e saj e jashtëzakonshme, vendosmëria dhe predha e pakufishme e kanë bërë atë një hapësirëtar në fushën e menaxhimit të dëshirës për fëmijë. Lindur më 1 janar 1989 në Skivjan të Gjakovës, Edona Mirakaj e kaloi vitin e parë të jetës në qytetin e lindjes, para se të shpërngulej në Ulm, me gjashtë motra e dy vëllezër të saj. Që në moshë të hershme zhvilloi një pasion për mjekësinë dhe dëshirën për të ndihmuar të tjerët. Që 16 vjeçe filloi të punonte në qendrën e dëshirës për fëmijë dhe, kështu, themeloi bazën për karrierën e saj. Edona Mirakaj përfundoi një trajnim trevjeçar dhe fitoi njohuri të gjerë në fushën e mjekësisë riprodhuese. Gurthemeli i saj për dije dhe zhvillim e çoi atë në studimin e menaxhimit të

shëndetit dhe menaxhimit të cilësisë. Me pasurimin e saj faktor dhe aftësitë e jashtëzakonshme drejtuese, ajo gradualisht mori udhëheqjen organizative të qendrave të dëshirës për fëmijë në Ulm, Stuttgart dhe Ravensburg, nën drejtimin e Dr. med. Friedrich Gagsteiger. Në vitin 2021 Edona mori vendimin guximtar për të bërë një biznes të pavarur. Qëllimi i saj ishte të krijonte një qendër unike hibride për dëshirën për fëmijë që i plotëson nevojat e pacientëve. Tek Bestfertility kënaqësia e pacientëve është në vend të parë. Edona punësoi një ekip të kualifikuar të mjekëve riprodhues dhe biologësh, që kujdesen me përkushtim për çdo rast, përfshirë edhe ato më të ndërlikuarat.

Ajo që e dallon Bestfertility nga qendrat e tjera është hyrja e konsultimit në linjë. Me anë të kësaj metode inovative pacientët mund të lidhen nga kudo dhe të marrin këshillim dhe kujdesin që kanë nevojë.

Edona Mirakaj vuri re se shumë çifte shpesh duhet të udhëtojnë shumë gjatë për të marrë një termin. Andaj, Bestfertility bashkëpunon me qendra partnere në gjithë Gjermaninë, për t'u ofruar pacientëve trajtim të rehatshëm dhe të cilësisë së lartë.

Por, Edona ka plane edhe më të mëdha. Bestfertility do të ndërtojë një klinikë shumë moderne në Sedelhofen, pranë stacionit të trenit në Ulm, të projektuar nga arkitekti i mirënjohur, Fisnik Dreshaj.

Dhe, duke u pajisur me teknologji dhe pajisje mjekësore të fundit, ky vend do të jetë një simbol shprese dhe përparimi për çiftet që shpresojnë shumë për një fëmijë.

Aspekti tjetër i rëndësishëm për Edona Mirakaj është se Bestfertility nuk ka krijuar vetëm një qendër për dëshirën për fëmijë, por edhe një vend ku çiftet ndjehen të kuptuar dhe të mbështetur.

Ajo vë në dukje dhimbjen emocionale dhe sfidat që çiftet ballafaqohen në rrugën drejt prindërimit dhe angazhohet që ata të mos kalojnë vetëm nëpër këtë proces.

Një tjetër hap i rëndësishëm në zhvillimin e Bestfertility është digjitalizimi i plotë i praktikës.

Me një aplikacion (APP), qendra e dëshirës për fëmijë mundëson komunikim me mbrojtjen e të dhënave dhe të sigurt.

Aplikacioni u jep pacientëve mundësinë për të bërë takime, për të parë raportet mjekësore, për të bërë pyetje dhe për të qëndruar në dijeni të trajtimit të tyre të fundit.

Kjo zgjidhje digjitale i lehtëson pacientët në qasjen ndaj kujdesit dhe u ofron një mënyrë të rehatshme dhe efektive për të komunikuar me ekipin e Bestfertility.

Përveç digjitalizimit, Bestfertility planifikon edhe hapjen e një qendre për dëshirën për fëmijë në Prishtinë, në bashkëpunim me Biohit, nën drejtimin e CEO Bujar Rexhaj.

Bashkëpunimi i ngushtë me Dr. Gagsteiger, mjek i njohur në Gjermani, do



të ndihmojë në vendosjen e qendrës dhe ofrimin e këshillimit të pacientëve në vend.

Me këtë zgjerim, Bestfertility do t'i japë më shumë çifteve mundësinë për të realizuar dëshirën e tyre për fëmijë dhe për të marrë kujdes mjekësor të cilësisë së lartë.

Çfarë sfidash të veçanta keni përjetuar gjatë karrierës suaj në qendrën e dëshirës për fëmijë dhe si i keni përballuar ato?

- Gjatë karrierës sime, në qendrën e dëshirës për fëmijë kam takuar shumë çifte që kanë luftuar me ngarkesat emocionale, mosbesimin dhe presionin e dëshirës së pambushur për fëmijë.

Çdo rast është unik dhe përfaqëson sfida individuale. Kërkohej shumë empati, durim dhe kuptim për të vënë re nevojat e secilit çift dhe për t'u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme. Për të përballuar këto sfida, nevojitet një qasje integrale, ku ekspertiza mjekësore kombinohet me mbështetje emocionale dhe komunikim.

A mund të na tregoni më shumë rreth konceptit hibrid të Bestfertility dhe përfitimet e konsultës në linjë për pacientët?

- Koncepti hibrid i Bestfertility është një qasje inovative, ku vë në përdorim

avantazhet e teknologjisë moderne për t'u ofruar pacientëve një kujdes të plotë.

Hyrja e konsultës në linjë ka përmirësuar qasjen në shërbimet tona në mënyrë të konsiderueshme. Pacientët tanë mund të marrin pjesë në seanca këshillimi nga shtëpia e tyre dhe të shmangin kohën dhe stresin e udhëtimit.

Kjo është veçanërisht e dobishme për çiftet që jetojnë larg nga vendndodhja e qendrës sonë.

Përveç kësaj, konsulta në linjë lejon një planifikim më fleksibil të terminit dhe rritë efikasitetin e proceseve tona, pa prekur cilësinë e këshillimit mjekësor.

Sa është e rëndësishme për ju të kujdeseni për nevojat e pacientëve të flasin shqip dhe si e përkrah Bestfertility këtë grup të veçantë njerëzish?

- Nevojat e pacientëve të flasin shqip janë shumë të rëndësishme, meqë vetë jam nga një familje e cila flet shqip.

Kam vërejtur se barrierat gjuhësore shpesh shkaktojnë vështirësi në komunikim dhe keqkuptime, veçanërisht në çështjet e ndjeshme, si, bie fjala, planifikimi familjar.

Në Bestfertility kemi përfshirë në ekipin tonë punonjës që flasin shqip,

të cilët shërbejnë si përkthyes dhe ndërmjetësues për pacientët. Kështu, ne krijojmë një ambient të besueshëm dhe të këndshëm për pacientët tanë që flasin shqip, ku ata mund të ndjehen rahat dhe të kuptuar.

Çfarë mesazhi dëshironi të transmetoni për gratë tjera që dëshirojnë të themelojnë kompanitë e tyre ose të bëjnë karrierë në një fushë të caktuar?

- Mesazhi im për gratë e tjera, që dëshirojnë të themelojnë kompanitë e tyre ose të bëjnë karrierë në një fushë të caktuar, është të besojnë në ëndrrat e tyre dhe të ecin përpara me guxim. Persekutoni pasionin tuaj, shfrytëzoni aftësitë tuaja dhe mos lejoni të demoralizoheni nga dyshimet ose pengesat.

Sigurisht, do të ketë rënie e sfida, por këto duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe për të bërë veten më të fortë dhe më të mirë.

Ju duhet të jeni të hapur ndaj ideve të reja, të gatshëm të merrni rreziqe dhe të ndërtoni një rrjetë mentorësh dhe mbështetësish që mund t'u shoqërojnë në rrugën tuaj.

Besoni në veten tuaj dhe në aftësinë tuaja për të arritur qëllimet tuaja.

Gratë kanë një potencial të jashtëzakonshëm për të qenë të suksesshme në çdo fushë dhe është e rëndësishme të shfrytëzohet ky potencial dhe të mbështetemi reciprokisht.

Si e shihni të ardhmen e Bestfertility dhe cilat janë synimet tuaja për vitet në vijim?

- Për të ardhmen e Bestfertility shoh një zhvillim dhe rritje të vazhdueshme.

Synimi ynë kryesor është t'i përmirësojmë shërbimet tona dhe të ofrojmë kujdes mjekësor të shkëlqyeshëm për pacientët tanë.

Dëshirojmë të forcojmë pozitën tonë si qendër udhëheqëse për dëshirën për fëmijë dhe të vazhdojmë të përqendrohemi në inovacione dhe përparime teknologjike, për të rritur shanset e suksesit dhe për të optimizuar rezultatet e trajtimit.

Dëshirojmë, gjithashtu, t'i zgjerojmë bashkëpunimet tona me qendra part-



nere në gjithë Gjermaninë, për të zgjeruar disponueshmërinë e shërbimeve tona dhe për t'u ofruar pacientëve një gamë më të gjerë vendndodhjesh.

PËRTEJ INTERVISTËS...

Sukseset që Edona dhe ekipi i saj përjetojnë në Bestfertility janë dëshmi e guximit, vendosmërisë dhe përkushtimit të pakufishëm.

Çiftet që me vite të tëra kanë luftuar pa sukses për të formuar një familje,

gjejnë shpresë të re në Bestfertility. Me metoda inovative të trajtimit, plane të personalizuara dhe kujdes të butë, Edona dhe ekipi i saj ndihmojnë pacientët të realizojnë dëshirën e tyre më të madhe - të mbajnë një foshnjë të shëndetshme në krahët e tyre. Edona Mirakaj nuk është vetëm një profesioniste e aftë në fushën e saj, por edhe një burim frymëzimi për gratë e tjera që dëshirojnë të ndjekin rrugën e tyre.



Me vendosmëri, përkushtim të pafund dhe pasion, ajo ka treguar se ëndrrat mund të bëhen realitet nëse jeni të guximshëm t'i ndiqni ato.

Si themeluese e Bestfertility, Edona Mirakaj ka vendosur standarde të reja dhe ka hapur rrugën për të ardhmen e menaxhimit të dëshirës për fëmijë. Koncepti hibrid unik i saj, që përdor avantazhet e teknologjisë moderne, për të ofruar kujdesin më të mirë për pacientët është rrugëdrejtues. Me hapjen e Klinikës moderne në Sedelhöfen në Ulm, Bestfertility do të vazhdojë të japë një kontribut të rëndësishëm në mbështetjen e çifteve që dëshirojnë të realizojnë dëshirën e tyre për fëmijë.

NË KËRKIM TË METODAVE INOVATIVE...

Edona Mirakaj dhe ekipi i saj janë të vendosur për të gjetur mënyra inovative, për të rritur shanset e suksesit dhe për t'u ofruar një përvojë pozitive pacientëve.

Edona Mirakaj - një themeluese e jashtëzakonshme, një vizionare dhe një përfaqësuese e çifteve që dëshirojnë të realizojnë ëndrrën e tyre më të madhe.

Me Bestfertility ajo ka krijuar një oazë shprese ku kufijtë e mundshëm vazhdimisht zgjerohen.

Historia e saj është frymëzuese për të gjithë, që me pasion dhe vendosmëri mund t'i tejkalojnë pengesat dhe t'i realizojnë ëndrrat e veta.





NE GJITHMONË E BËJMË IMAZHIN E
ARKITEKTURËS TË PËRSOSUR



 www.dinoqeramika.store



HAJNI NË BALLË TË OXHAKUT!



Në Kosovë - nëse je i papunë, je i humbur dhe i pashpresë.

Nëse je punëtor me një pagë minimale, mjek, inxhinier apo edhe i ndonjë profesioni tjetër me pagë pak më të madhe, je luftëtar i mbijetesës. Por, do të jesh i parespektuar, i injoruar...

E, nëse je hajn i rangut të lartë, nëse fiton pa djersë, je i respektuar, i lavdëruar, i nderuar...

Hajn po, por në ballë të oxhakut ama!

*
Shpesh na ka rënë të dëgjojmë: E vërteta është e hidhur!

E vërteta nuk është as e hidhur, as e ëmbël, as e bardhë, as e kuqe...

E vërteta është fillimi dhe fundi, tërësia vetë. Por, për kë është e vërteta e hidhur?

Për mashtruesin!

Për mjeranin që e ka mashtruar veten me iluzione se është dikush dhe kur ia thua të vërtetën bëhet helm e vrer!

E vërteta është e hidhur për gënjeshtarin, për matrapazin, për hiçin!

E vërteta është e vërtetë!

Po, edhe rrena është rrenë dhe mbetet rrenë...

*

Është e çuditshme se njerëzit që nuk dinë se kush janë, përpiqen të jenë dikush dhe kanë për qëllim të bëhen dikush.

E, të tillët nuk janë të paktë në përditshmërinë tonë.

Shumicën e tyre i ke në pozita pushteti. Eh, ç'të bësh?!

*

Një i ri, djalosh, u shpallë njeriu më i mençur. E kishte koeficientin më të lartë të inteligjencës.

E pyetën gazetaret:

"Prej cilave sisteme filozofike mëson?"

"Rri me njerëz!", përgjigjet djaloshi.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Të veçantit...



Ymer Shkreli, shkrimtari dhe dramaturgu i pashoq

Ymer Shkreli është shkrimtar, dramaturg, prozator, poet, radio-dramaturg dhe skenarist filmash.

U lind në Shkrel të Rugovës, më 1945. Shkollën fillore e kreu në Haxhaj, Normalen në Prishtinë. Studioi Gjuhën e Letërsinë Shqipe në Prishtinë.

Ishte redaktor i gazetës "Rilindja".

Momentalisht jeton në Zvicër.

Botoi një varg romanesh. Me ç'rast përmendim: "Vjeshta e vdekur", "Njeriu në bisht", "Vdekja në ajër të pastër", "Rapsodi kosovare" (katër romane: "Kali i Trojës", "Heroi në gjumë", "Shpendkeqja", "Zeka i Zi") e të tjerë.

Botoi në vitin 1969 monodramën "Alter Ego", pastaj monodramën "Shqiptari me duar në xhepa", dramën "Trilogji ilire", e shumë të tjera.

Botoi edhe shumë vepra e tregime për fëmijë...

Hys Shkreli, gazetari e moderatori i pazëvendësueshëm

Hysi është vëllai i shkrimtarëve Azem e Ymer Shkreli dhe i gazetarit Adem Shkreli.

Hys Shkreli ishte njëri nga moderatorët më të mirë jo vetëm në ish- Radiotelevizionin e Prishtinës, por në gjithë botën shqiptare.

Zëri i tij i thellë dhe me karaktere, finesat dhe inteligjenca e të shprehurit para kamerës, si dhe qëndrimi i tij brilant mbetet i pazëvendësueshëm dhe secilit shikues të Televizionit të Prishtinës do t'i ketë mbetur në kujtesë.

Hysi ka moderuar emisionin "Eureka", pastaj "Në orët e vona", si dhe emisione të tjera kulturore, në veçanti ato të zhanrit të muzikës, që nga themelimi i Radiotelevizionit të Prishtinës në vitin 1976 e më pas.

Por, Hysi është edhe ndër gazetarët e parë të Televizionit të Prishtinës që u vendos në SHBA dhe që më shumë se tridhjetepesë vjet jeton në Nju-Jork.





Kush ishte Nazmi Krasniqi që u lind në qeli dhe vdiq në qeli?

Ajshe Gjonbalaj, nga Vuthaj, e burgosur politike e viteve 80, ka qenë pjesëmarrëse e demonstratave më 1968 dhe 1981, ku edhe ishte dënuar me burg 13 vjet, e që shtatë prej tyre i ka vuajtur në disa burgje, ku shumicën e mbajti në burgun e Pozharevcit, në Serbi.

Ajshe Gjonbalaj, në një intervistë ekskluzive që e pat vite më parë në Revistën tonë, "Kosovarja", krahas jetës

së saj në Vuthaj të Malit të Zi, shkolimit në normalen e Pejës dhe të kryerjes së Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më 1971; të punës së saj dy vjet në vendlindje, e më pastaj në Llukar të Prishtinës, të pjesëmarrjes në demonstrata të vitit 1981 në Prishtinë, arrestohet nga regjimi i kohës më 23 mars 1983, në vendin e punës ku punonte, në shkollë, në Llukar. Dënimin me burg e mbajti nga 23 mars 1983 deri më 29 nëntor 1990. Tash jeton në SHBA. Por, këtë herë nuk do të shkruajmë për jetën e saj në burgjet jugosllave, por cekim një rast ku ajo thotë: "18 vetëve na kanë burgosur në grupin tonë. Kryetari ynë i grupit ka qenë Rifat Kafexholli. Grupi ishte shumë aktiv dhe i guximshëm, aq sa na quanin "bombaçët", grup që njiheshim si minues të Jugosllavisë. Dy net burg të rëndë i kemi mbajtur

në Prishtinë, ditët tjera në Mitrovicë. Një vit u mbajtëm në burg nën hetime në Mitrovicë. Na kanë rrahur shumë... Pastaj, na e shqiptuan dënimin në Prishtinë. Rifati u dënua me 20 vjet burg, unë me 13, kurse vëllai im, Beqiri, me 2 vjet; Nuhi Bunjaku me 15 vjet, Shaqir Ruhani me 15 vjet, Hazir Xhafolli me 12 vjet, Nazmi Krasniqi vdiq në qeli, në Pozharevc, në burgun qendror. Është interesante: Nazmiu ishte i lindur në burg nga nëna e burgosur dhe vdiq në burg, si i burgosur! Shumë prej të burgosurve të grupit tonë kanë mbetur me pasoja të përjetshme, ku dy prej tyre edhe kanë vdekur në burg. Disa prej tyre edhe tash janë psikikisht keq, e disa me pasoja të tjera fizike. Sidoqoftë, të gjithë kanë qenë të shkatërruar".



Pamje e fshatit Marec

Cilat katunde të Prishtinës do të zhduken së shpejti?

Disa katunde të komunës së Prishtinës, e që para lufte ishin me shumë banorë, nga paslufta janë me pak njerëz, për të mos thënë të boshatisur plotësisht.

Tash Mareci, Hajkobilla, Radasheci, Gillogovica, Prapashtica etj., më shumë komentohen si vende se dikur kishte banorë në to sesa si vende se në to banon ndokush...

Sepse, të gjitha familjet që jetojnë në këto fshatra po të tubohen në një vend, nuk bëjnë sa një lagje e dikurshme e cilitdo fshat që e përmendëm...

Bie fjala, fshati Marec i Komunës së

Prishtinës dikur kishte tri shkolla fillore, kurse tash funksionon vetëm një shkollë në të cilën vijojnë mësimin rreth 20 nxënës!

Bukuria e fshatit Marec është e veçuar në komunën e Prishtinës. Por, bukuritë natyrore e ajri i pastër, si duket, nuk janë arsye e mjaftueshme që banorët e kësaj ane të qëndrojnë këtu, meqë fshatin me hapësirë prej 112 km katrorë e kanë braktisur shumica e popullsisë për t'u vendosur në qytet. Kështu, në vendin ku dikur jetonin qindra banorë, tash ka vetëm 100 sosh.

Por, të ishin vetëm këto katunde në

Kosovë! Ku janë fshatrat e boshatisur në Drenicë, në Dukagjin e gjetiu?!

DURO POPULL, DURO!

“Duro popull, duro!”, janë fjalë të cilat i dëgjova ditën e marte në pazarin e Prishtinës, teksa blija gjëra në treg. E, nga kush u thanë?

Këto fjalë u thanë nga shitësi i bananeve, pranë të cilit u rrëzua një plakë, e që rrëshqiti mbi lëvoren e një bananeje, sepse tregun e Prishtinës nuk e pastron askush, madje as ata që punojnë në të dhe ballafaqohen çdo ditë me papastërtinë që i rrethon.

Selim Rama



UNION BUSINESS

ALBANISCH & DEUTSCH



Unioni i bizneseve në Gjermani organizon takim b2b me prodhuesit dhe përpunuesit e drurit nga Kosova

Përmes Unionit të Bizneseve (UB) shqiptare-gjermane në Gjermani në bashkëpunim me Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHDPK), Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), dhe mbështetur nga USAID Kosovo Compete Activity dhe Caritasi Zvicëran në Kosovë.

U organizua event i B2B dhe panairi "KOSOVA DAY", në Köln, Gjermanisë. Panair ky ku u bashkuan të gjithë për-

faqësuesit e kompanive, nga Gjermania dhe Kosova.

Unioni i Bizneseve shqiptare – gjermane në Gjermani, me drejtorin ekzekutiv Fadil Abdullahu, anëtarin e kryesisë Shkëndije Pacolli si dhe kryetarin e degës së Unionit në Frankfurt, Ukë Blakaj, vizituan të gjitha shtandet e kompanive anëtare të saj të cilat ishin pjesë e këtij panairi poashtu edhe kompanitë pjesëmarrëse nga Kosova, të cilave i'u ofrua përkrahja e

shoqatës si një urë lidhëse në mes të Gjermanisë e Kosovës dhe anasjelltas.

Krahas përfaqësuesve të KIESA dhe USAID, Nënkrjetari i Unionit të Bizneseve, Zenun Krasniqi, në këtë takim B2B, përshëndeti të gjithë të pranishmit duke i falënderuar për kooperimin, që sipas tij Unioni i Bizneseve do të vazhdojë të bëjë promovimin dhe të luaj rol in e urës lidhëse në mes të kompanive që veprojnë në Gjermani dhe atyre nga vendlindja.





Shtatzënë me babanë e 5 fëmijëve!

E dua dhe më dashuron, por e di se e do edhe gruan e tij, me të cilën i ka 5 fëmijë. Por, e vetmja gjë që më mundon është pyetja se çfarë do të bëhet me jetën time, si dhe a do të mbetëm gjithmonë dashnorja e tij...

Ishim duke festuar pesëvjetorin e njohjes sonë dhe po kalonim çaste shumë të bukura bashkë, kur unë papritmas ndjeva një lëvizje në bark dhe menjëherë u shtanga. I tregova për këtë të dashurit tim, por ai nuk i kushtoi rëndësi kësaj pune. Ndërkaq, mua më shkoi mendja menjëherë se kisha mbetur shtatzënë, edhe pse nuk dëshiroja të mendoja për një gjë të tillë. Atë natë as që kam vënë gjumë në

sy. Mendja më shkante gjithkund... Nganjëherë mendoja në ndonjë gjë të bukur, por realiteti në të cilin ndodhesha m'i prishte të gjitha... Shpresoja të mos ishte kjo që po mendoja dhe të nesërmen me shumë frikë shkova te gjinekologu. Ai menjëherë më tha se isha shtatzënë dhe atë, madje, në muajin e katërt, kur veç kishte filluar të bëhej vonë për abortim nëse dëshiroja kështu. Kur m'i tha këto fjalë e di se mu morën mendtë

dhe më nuk di se si ka rrjedhur ngjarja...

BABAI I 6 FËMIJËVE

Pasi më kaloi ajo kllapi, u këndella pak dhe bisedova me mjekun. I tregova se nuk ishte e mundur të isha shtatzënë, meqë ciklet mujore i kam pasur me rregull çdo muaj dhe nuk kisha vërejtur se po më fryhej barku. Edhe ndonjëherë kur më dukej barku paksa i fryrë, mendoja se ki-



sha filluar të trashesha Apo kisha ngrënë më shumë se që ishte nevoja. Dhe, që nga ajo ditë, ndjenja që mbaja në bark një fëmijë të pafajshëm më mbyste, por edhe më dhimbsej fëmija. i cili do të lindte jashtë një martese të rregullt. Pas pak ditësh në zyrën time erdhi gruaja e të dashurit tim, së bashku me vajzën e vogël të saj. Nuk dija çfarë t'i thosha në atë moment kur ajo pa barkun tim paksa të fryrë. Kur e vërejti barkun tim, thellë ofshani...

GRUAN E DASHNORIT TIM E BËRA MIKE!

Një natë, derisa po flija, më doli gjumi pasi ndjeva një dhembje, e cila ma nxori gjumin. Vërejta se kisha gjakderdhje, e që dhembja sa vinte e më shtoej.

Nuk dija çka të bëja... Pas pak vendosa ta thërrisja të dashurin tim në telefon. Në telefon u lajmërua gruaja e tij. Në çast u stepa. Në mendje mu soll shumëçka... Por, pasi i shpjegova pse kisha thirr në atë kohë, për çudi, ajo u tregua shumë gjakftohtë dhe më tha se menjëherë do vijinë bashkë me burrin që t'më ndihmonë...

Pas pak erdhën dhe më dërguan në spital. Atje mu desh të abortoja, meqë fëmija nuk kishte shtuar peshë...

Ishin momente të vështira për mua...

Vetëm qaja.. mendtë donin t'më dilnin nga koka... Kërkoja të vdisja në ato çaste...

Por, pas pak vendosa të përmbahesha dhe kam dëshirë të mos i ndodhë asnjë vajze ajo që më ndodhi mua...

Pasi më lëshuan nga spitali kisha nevojë të largohesha nga ai ambient ku ndodhesha.

Doja të ikja nga realiteti të cilin e kisha përjetuar. Shkova në Shëngjin dhe atje u vendosa në një banesë private, me qëllim që të shëtisja bregut të detit dhe të lirohesha sado pak nga ajo që kisha përjetuar. Atje qëndrova një muaj. Dhe, dhembja ime u qetësua pak, por jo aq sa të ndihesh mirë si para asaj që më ndodhi...

Megjithatë, nuk dëshiroja më t'ia ndieja as zërin të dashurit tim, e lëre më ta shihja...

Për çudi, mu largua shumë nga zemra...

Vildanja, Prishtinë

Pse numri i shqiptarëve beqarë po rritet?

Burrat e rinj dhe të moshës së mesme janë më të vetmuarit që kanë qenë ndonjëherë në breza dhe ndoshta situata të përkeqësohet.

Gjatë 30 viteve të fundit, burrat janë bërë një pjesë më e madhe e një grupi në rritje të beqarëve afatgjatë.

Dhe, ndërsa gjithnjë predikohet se ju nuk keni nevojë të jeni në një lidhje për të qenë të lumtur, burrat zakonisht janë më të lumtur dhe më të shëndetshëm kur kanë një partnere. Këtu janë tri tendenca në peizazhin e marrëdhënieve që sugjerojnë se burrat heteroseksualë kanë një rrugë të vështirë përpara.

E, pavarësisht nëse sapo keni filluar të dilni ose jeni divorcuar dhe jeni duke dalë sërish, aplikacionet e takimeve janë një shtytës i madh i lidhjeve të reja romantike.

Problemi i vetëm është se mbi 62% e përdoruesve janë burra dhe shumë gra janë të mbingarkuara me sa shumë opsione kanë.

Andaj, me kaq shumë opsione nuk është për t'u habitur që gratë janë gjithnjë e më selektive. Kështu, vajzat dhe gratë e moshës 25 deri në 45 vjeçe preferojnë burra që janë emocionalisht të disponueshëm, komunikues të mirë dhe ndajnë vlera të ngjashme.

Ku janë, ç'bëjnë...

Vesa Luma në skaj të botës

Këngëtarja e njohur, Vesa Luma, ka ardhur nga Zelandë e Re, ku edhe jeton, për pushim me bashkëshortin e saj, reperin Big Basta. Këngëtarja e hitit "Jemi dhe s'jemi" flet haptazi për katër vjetët e fundit të jetës, për lidhjen e fortë me Big Bastën dhe

sa inkurajues dhe shok i mirë ka qenë ai për të në rrugëtimin e tyre bashkëshortor. Ajo është e lumtur se jeta në Zelandë të Re i dha qetësinë, por i mori frymëzimin. "Nuk kam më frymëzim", shprehet ish-prishtinasja Vesa Luma.



Yllka Gashi në skajin tjetër të botës

Aktorja simpatike dhe shumë e adhuruar nga publiku, Yllka Gashi, ka kohë që jeton në SHBA. Pra, krejt në Perëndim të botës, karshi Vesa Lumës që jeton në Zelandë të Re.

Aktoren e talentuar të serialit "Familja Moderne", ku luajti rolin e "Zanës", e përcollën shumë suksese në teatër e film, por ajo zgjodhi të emigronte bashkë me të shoqin dhe të bijën në SHBA.





YOUR STORY STARTS

HERE.

www.marinabay.ae

Martohen shpejt, ndahen edhe më shpejt!

Dy të rinj, që në dukje sapo kishin kaluar muajin e mjaltit, grindeshin në tarracën e restorantit në të cilin ndodhesha unë me dy kolegët e punës, në periferi të Prishtinës. Me ton herë të ngritur e herë paksa më të butë, teksa flisnin shikonin përreth nëse i dëgjonin të tjerët, që këto ditë shiu ishin në numër të paktë në tavolinat tjera. Por, kjo ka pak rëndësi, krahasuar me atë që flisnin ata se si janë njohur...

Burri i thoshte nuses së veshur me xhins të shqyer në gjunjë se para martese një shok i tij, me kohë ia kishte bërë me dije, se femrën që do e merrte grua nuk vlen më shumë se për një natë...

Por, dashuria ia kishte mbyllë sytë dhe kishte vendosur të martohej, meqë i fliste zemra e jo mendja. Nusja, pastaj, kërkoi nga burri ta

njihte atë person që ka shpikur ndaj saj, por burri nuk i tregoi...

"Unë s'të gjeta të virgjër dhe s'ke përse kundërshton!", ia ktheu burri me nervozë.

"Por, ti nuk kërkove përgjigje për mosvirgjërinë time, madje as që më pyete!

Unë kam qenë në lidhje me një person para teje, sepse nuk e kam

ditur se t'i ekziston diku e do më paraqitesh!", ia ktheu ajo me ton të ashpër.

Dhe, pas këtyre fjalëve, sa mbyllë e hapë sytë, gruaja u ngrit dhe doli jashtë, kurse burri mbet me filxhanin e kafesë në dorë, të cilin e sillte pa kontroll dhe lëshonte ofshamë pas ofshame.

S. M.



BREZOVICA
HOTEL & SPA



"Brezovica" Hotel & Spa është i vetmi hotel me pesë yje në Brezovicë. Mysafirët mund të zgjedhin nga 72 dhoma të mobiluara në një stil luksoz-modern, secila prej tyre ofron një pamje spektakulare mbi të gjithë perlinë e Brezovicës. Dhomat dhe suitat moderne me dizajnin dhe arkitekturën unike kombinojnë një përzierje elegancë, funksionaliteti dhe qendrueshmërie.

REZERVO TANI!

+383 49 30 10 30

*Përjetoni të jashtëzakonshmen në
1100 metra lartësi mbidetare*

www.brezovichotel.com

Lotët e Imer Sefë Mleçanit në tregun e "Ulpianës"



Të mërkurën që shkoi, kah mesdita, disa të moshuar, mu te porta e tregut në Ulpianë, përqaфонin një burrë të moshuar me plis në kokë. Kontrasti mes plisit të bardhë dhe fytyrës së rreshkur nga ky pak diell pranveror, binin në sy nga larg.

Një burrë rreth të shtatëdhjetave, pasi iu ofrua, e pyeti:

"A je ti Imeri i Sefë Mleçanit?"

"Po, unë jam", iu përgjigj ai.

Dhe, fjalë pas fjale e muhabet pas muhabeti, burra të shumtë, sikur të ishin ftuar te porta e tregut, ndalen dhe e përqafojnë Imerin, djalin më të madh të Sefë Mleçanit. Andaj, i rrethuar mes burrave si dikur në odat ku këndonte, Imerit i pikojnë lotët...

"Kam mbetur vetëm unë prej gjithë djemve të Sefës", foli Imeri me lot në sy. Dhe, tek vazhdon biseda, ai që e përqafoi Imerin i thotë se ti me Osmanin e Brahimin dikur kishin kënduar në dasmën e tij...

"U plakëm! Dikur ka qenë ndryshe... Por, krejt çka nuk po ndryshuaka në jetë qenkan hjekat", thotë Imeri.

KUSH ISHTE SEFË MLEÇANI?

Për ata që nuk e dinë, shtrohet pyetja:

Kush ishte Sefë Mleçani me djem?

Për brezat e rinj, e që nuk merren shumë me kohët e vjetra, është mirë ta kujtojmë të kaluarën për të parë se çka ka ndodhur dhe si ka rrjedhur historia që solli shtetin e pavarur të Kosovës, meqë koha deri te

çlirimi i Kosovës dhe shpallja e pavarësisë ishte një rrugë shumë e lagur me gjak.

Në fakt, Sefë Mleçani, e që njihej në masë si Sefë Brahim, kishte vuajtur shumë. Ishte fëmija i vetëm i prindërve. Nuk kishte pasur as vëlla e as motër.

Kur Sefë Mleçani ishte i fejuar, pak para martesës i kishte vdekur e fejuara.

Andaj, miqtë ia kishin dhënë vajzën 14-vjeçare, Sadberen, për nuse.

Në natën e parë të martesës Sefa i ishte lutur Zotit që t'ia dhuronte nëntë djem: gjashtë të jetonin, e tre të vdisnin në luftëra!

Dhe, Zoti Sefës ia kishte dhënë nëntë djem e dy vajza...

Por, dy djem i kishin vdekur në moshën 4-5 vjeç, e shtatë ishin rritur e bërë burra, bashkë me dy motra.

Pastaj, njëri ishte vranë në rrethana misterioze, pas arrestimit gjatë shërbimit ushtarak në APJ, në burgun e Idrizovës në Maqedoni.

Ndërkaq, dy djem të tij ranë dëshmorë në luftën e vitit 1999.

Andaj, kur ishin vranë Beqa dhe Ismeti, vëllezërit e mbetur nuk e kishin marrë shumë tragjike, sepse me atë akt ishte përmbushur lutja e Sefë Mleçanit në natën

e martesës...

Rapsodi Sefë Mleçani ka vdekur në vitin 1975.

FJALËT E IMER SEFË MLEÇANIT...

"Kam mbetur vetëm unë e nuk po e njoh veten!", thotë Imeri, teksa ishte i rrethuar nga të tjerët në portën e tregut të "Ulpianës".

"I sheh njerëzit se si të kanë rrethuar Imer! Është kënaqësi t'i shohësh rreth vetes. Sepse, kjo tregon se nuk të kanë harruar", i thotë ai që ndodhej afër tij.

"Kemi vuajtur shumë. Na ka përcjell UDB hap më hap nëpër oda! Një vëlla na e vranë në burg gjatë shërbimit ushtarak jugosllav, e dy na i vranë në luftë. Andaj, brezat e rinj nuk duhet t'i harrojnë gjërat që kanë ndodhur, se kanë qenë histori të përgjakshme që sollën lirinë", ia kthen Imeri.

Dhe, fjalë pas fjale, vjen koha e ndarjes nga grupi, ku secili merrte drejtimin e vet, duke kthyer kokën herë-herë prapa në drejtim të Imerit, i cili vetë i dyti shkoi në drejtim të "Ulpianës".

Safet Krivaça



Asim Abdurrahmani

“Intervistë me vetveten” i Petro Markos

Pse e pushkatoi Enver Hoxha dhëndrin e Bedri Pejanit?

Libri “Intervistë me vetveten”, i shkrimtarit shqiptar Petro Marko, i botuar në fillim të viteve 90, pas shembjes së regjimit komunist, u botua dhe ribotua disa herë. Pse?

...Mua më shpinë te Burgu i Vjetër në Tiranë. Aty, në birucën e katit të poshtëm, gjeta tre vetë: Asim Abdurrahmanin, që e njihja se ishte dhëndri i Bedri Pejanit; Gjush Dedën, një shkoderan; Asllan Ypin. Sapo më panë, u habitën: “Edhe ti këtu!

Asimi më tha:

- I kisha thënë gruas sime të vinte tek ti që të interesoheshe për mua. Më kanë dënuar me vdekje! Nuk e di pse...?! Unë Babushin (Bedri Pejanin) nuk mund ta mohoja se e kam vjehërr...

Ishim katër vetë në një birucë. Cilido tregonte të tijat. Aty dëgjova Asllan Ypin të na tregonte për jetën e tij dhe të Enverit në Francë...

Pastaj, tregonte edhe për në Tiranë:

- Një ditë kalova andej dhe e pashë që pozonte në derën e dyqanit “Flora”, ku njoha disa komunistë. I thashë frëngjisht: “Po ti, Enver, ç’kërkon këtu me të kuqtë?”

Dhe ai, po frëngjisht:

“Jam këtu, me qëllim që t’u... nënën gjithë komunistëve. Asnjë nuk do të më këmbë!”

Dhe, siç do të shohim, ai, me të vërtetë, qysh atëherë nisi t’i eliminonte komunistët e orëve të para...

- Po ne që nuk jemi komunistë? – tha Gjush Deda, – pse na arrestoi e na dënoi me vdekje?

Mendoja: “Kam qenë në burgje të tjera, me shokë të dënuar me vdekje dhe gjithnjë jam kredhur në një trishtim shumë të thellë...! Ç’ka bërë njeriu?! Ç’mënyra krimi, mundimi dhe degjenerimi ka gjetur për të dënuar veten?! Më kujtohet që thoshin në burgun e Barit se inxhinieri i cili ndërtoi burgun, pasi e mbaroi, vrau veten. Burgjet janë varri i të gjallëve. Njeriu, në disa demokraci, ka gjetur mënyrën e dënimit të fajit ose të krimit: izolimi në vende të largëta; kanë krijuar komunitete fajtorësh, që punojnë e jetojnë të izoluar nga bota tjetër, por ama janë në shoqëri, shohin diellin, pa çka se bëjnë një jetë, pa krahë për të fluturuar...!”

I PUSHKATUAN DUKE UA LËNË BUKËN NË FYT!

Ja një skenë çnjerëzore: Ishim duke ngrënë bukë të katër bashkë; kishim shtruar ato që na kishin sjellë familjet tona në sefertasë. Mua më sillte ushqim rregullisht përditë, gruaja ime, Safoja. Atë e ndihmonte e ëma, Shazija, që gatuate shumë mirë. I bashkuam gjellët dhe që të katër, këmbëkryq, filluam të hanim. Nuk kaluan

pak minuta dhe dera kërciti e u çel.

U futën dy oficerë të Sigurimit, Haznedari dhe Stavri, të zellshëm për ofendime dhe tortura nga më çnjerëzoret. Nuk na thanë: “Ju bëftë mirë dreka,” po:

- Ti, Asim Abdurrahmani, dhe ti, Gjush Deda, ngrihuni!

Nuk e di si guxova dhe fola:

- Dale të mbarojmë drekën...! Tani sapo shtruum!

- Pusho ti, agjent i fëlliqur! Ju ngrihuni, se drekën e mbaroni në atë botë.

Shtangëm. Gjush Deda, trim, tha:

- Asim, ngrihu! Të shpëtojme nga kjo pjellë e keqe, që ka lindur ky vend fatkeq i pushtuar nga Titoja, që ka këtu si xhelat Enverin!

Më erdhi të ulërija kur pashë Stavrën, ta godiste me këmbë në kokë dhe ta shante. - Ngrihuni!

Gjush Deda, i tha Asimit:

- Mos u ligështo. Mbaju burrë, se ne bëjmë pjesë te kurbanet, në ato mijëra kurbane që Enver Hoxha i ther për perëndinë e tij, Tito.

Përsëri Stavri e goditi rëndë. E hoqi zvarrë. Me Asimin u përqaftuam me lot në sy.

Dëgjova:

- Në dalçi gjallë këtej, thoni se vdesim të pafajshëm!

Dera u mbyll. Unë dhe Asllani ndenjëm në këmbë me lot në sy, ndërsa radioja shpërndante me zë të lartë me anë të megafonit të vënë në oborr të burgut “Orën gazmore” dhe i bënte të qeshnin ata që e dëgjonin.

Ishte edhe kjo një nga ato mijëra skena makabre që kam parë gjatë gjithë jetës...

Jam në hall...

Gruan nuk ma do familja!

Fillova me një ëndërr në garazhin tim dhe përfundova te gruaja ime pse nuk ma do askush! Ishte një ëndërr që përfundoi, në realitet, jo bash e mirë. E, të gjithë jemi pjesë e këtij realiteti: edhe të mençurit, edhe budallenjtë...

E kisha lënë për nesër takimin për kafënë e mëngjesit me atë që e kisha pritur më shumë se dhjetë vjet. Vinte nga Zvicra në Prishtinë dhe doja ta shihja me sy, meqë i kishim shkruar gjatë njëri-tjetrit, me vite...

Nata afrohej. Bëra një dush në banjë dhe u rrova mirë që nesër të dukem sa më bukur.

Më doli gjumi dy orë para mesnate dhe u befasova për të parën herë në jetë se si nuk më doli asgjë këtë natë të ma prish të nesërmen. As nuk vdiq kush, as nuk u sëmure kush...

FORCËN MË NUK PO E DO AS AMERIKA!

Por, pak para se të agojë dita, vjen një krismë nga garazhi. Hajnat e kishin hapur derën e veturës.

Dal shpejt, me pizhame si isha, dhe tre fëmijë deshën të ikin, por dy i rroka për krahësh.

"Kush u ka thënë ta hapni veturën?", u thashë.

"Kjo nuk është e jotja!", më thotë njëri.

"Unë i kam letrat në veturë që të bindeni se është imja dhe bashkë do të shkojmë në polici", u them.

Por, në mendje më shkon se në polici mund t'më nxjerrin telashe: kush janë këta; pse i ke sjellë me forcë, e të tjera të ngjashme...

Sepse, sot forcën nuk e do askush...

As Amerika më nuk po e do forcën. Po thonë: "Bisedoni, gjeni zgjidhje, nuk duam forcë në Veri të Kosovës!"

"Çka të bëj?", pyes veten.

Më mirë ta thërras ndonjë polic e t'i verifikojnë kush janë, më shkon në mendje.

Por, në rrugë nuk lëviz njeri me uniformë polici. Më në fund, ata tërhiqen dhe shkojnë. Dhe, pasi largohen, në

kokë më vijnë shumë ide...

Si nuk ua bëra një foto me telefon celular, bile?!

JAM BËRË PËR HAMAM TË HYRËS!

Dhe, derisa meditoja për këtë problem, kalojnë dy policë, e njëri prej tyre më pyet:

"A të duhet gjë?"

"Hamami i Hyrës!", i them.

"Kush është Hyra?", pyeti po i njëjti.

"Lëre tani se shumë jeni vonuar, e ku t'i gjej tash ata që e kishin hapur veturën time!"

"A ke pasur gjë në të?"

"Jo, nuk kisha. Më e mira që nuk e kisha as gruan në të se mund t'ma kishin rrëmbyer!"

"Jo, rri pa gajle, ata nuk ta duan gruan!", më thotë i dyti.

Dhe, zgjohem nga shtrati i shokuar nga ëndrra e mëngjesit. E, mendja më shkoi menjëherë te gruaja, te fjalët e policit se gruan nuk ta do askush. Madje, nuk po ma do as familja!

Mirëpo, kur e kthej kokën kah gruaja, ajo ja kishte rrasë gjumë...

S. Murturi



KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu



Gadimen pa e shëmtojnë gurthyesit!

Fshati Gadime e Poshtme i Lipjanit është ndër vendbanimet më të mëdha në Kosovë. Shtrirja e tij nis nga magjistrалja Prishtinë-Shkup, vazhdon nëpërmjet grykës së kodrave Murtur dhe Surgjak dhe përfundon afër fshatrave Vrellë e Plitkoviq, e që janë vise malore.

Por, gurthyesit ma kujtojnë Gërdecin në Shqipëri...

Te vendi i quajtur pishat në Gadime një biznesmen nga Maqedonia që moti ka uzurpuar një hapësirë toke kinse për të ngritur një fermë dhish, e që, në fakt, nuk i pa askush. Ishte

qëllimi i uzurpimit të një vendi shumë piktoresk, prej të cilit shihet tërë rrafshi i Kosovës.

Aty sot qëndrojnë dy shtëpi, brenda të cilave bëhet roje për to. E, kush jeton aty, nuk dihet.

Ajo që dihet është se janë uzurpuar dhjetëra hektarë tokë që i posedon dikush, lokacione që i janë dhënë një të panjohuri nga Maqedonia, në mandatin qeverisës të kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja.

Është folur e debatuar shumë herë në asamblenë komunale të Lipjanit për këtë skandal, por kurrë ky problem nuk është zgjidhur.

Këshilltarët e Asamblesë komunale të Lipjanit nga fshati Gadime thonë se nuk dinë si ka ardhur ai aty dhe nuk i ka pyetur askush...

GADIMEN E KANË VËRSHUAR GURTHYESIT!

Kodra e Gadimes nga ana e Surgjakut është e mbuluar nga gurëthyesit, që e kanë shkatërruar ekologjinë e fshatit.

Te vendi i quajtur "Kodra e qelbësit", që zbrret kodrës, më saktë te vendi "Kodra e Smajlit", një gjysmë kodre është nën rrethoja teli, e që ruhet edhe nga qentë!

Është vend që ka një tunel, nëpër të cilin hyjnë dhe dalin me tona dinamit, pra materie eksplozive, e që po doli situata nga kontrolli, do ta qojë në erë gjysmën e fshatit dhe do ta dëmtojë shpellën e Gadimes.

Përballë, nga ana e malit, kanë vënë tela gjemborë dhe askush nuk di kush e ka pronësuar, por dihet se është de-voja e një nënkodre tjetër eksplozivi. Pastaj, janë katër a pesë gurëthyes që sjellin pluhur në fshat, aq sa më nuk mund të dilet në natyrë!

Andaj, shtrohen pyetjet:

Si ta pengojmë rrezikun që po i kanoset Gadimes?

Si ta pengojmë një Gërdec të ri?

Si t'i largojmë uzurpatorët që kanë pronësuar dhjetëra hektarë tokë ekologjike?

S. K.

BOOM

**Shqipe
Sylejmani,**
*shkrimtarja unike
që historitë
e gjejnë vetë*

*Veç me setër
pa sutienë,
ky është
trendi
që sjellin
të famshmet
tona*

Veç me setër pa sutienë, *ky është trendi që sjellin të famshmet tona*





Kejvina Kthella



Rita Ora



Nora Istrefi

Një nga veshjet që po bien në sy kohëve të fundit është edhe setra pa sutienë, duke lënë gjoksin të shfaqet më shumë.

Këtë modë po e ndjekin këngëtaret, moderatorët, e, së fundi, edhe disa aktore e politikane.

Për disa kjo mund të cilësohet trend i momentit, e për disa veprim që nuk do ta bënin asnjëherë.

Këtë trend te artistet tona e para e filloi Rita Ora, në vitin 2014, në një eveniment me rëndësi.

Ndërkaq, viteve të fundit me këtë stil veshje janë parë: Arbana Osmani, Elvana Gjata, Jonida Maliqi, Antonela Berisha, Marigona Krasniqi, Keisi Medini, Fjoralba Ponari, Adriana Matoshi, Nora Istrefi, Zhaklinë Lekatari, Kejvina Kthella dhe shumë personazhe të ndryshme publike.

Shtrohet pyetja: Ky trend është në modë apo jemi një hap para të tjerëve?

Edona Vllasaliu-Bajoku

Shqipe Sylejmani, shkrimtarja unike që historitë e gjejnë vetë

Shqipe Sylejmani tashmë është emër i njohur për opinionin publik shqiptar, falë dy librave të saj të suksesshëm, "Barrë dhe Bekim" dhe "Dinjtet dhe falje", të cilët morën vëmendje mediatike shkaku i fabulës së veçantë. Shqipja sjell për lexuesit, mërgimtarin e vërtetë, atë që, ndoshta, nuk njihet si duhet, për çka mund edhe të paragjyko-

het. Librat e Shqipe Sylejmanit tentojnë të thyen barrierën, stigma, por edhe ta vënë femrën në fronin e merituar. Më konkretisht, kush është Shqipe Sylejmani, shkrimtarja që shkruan gjermanisht e mendon shqip?

Shqipe, sa ndjehesh shqipe?

- Ndihem shumë "shqipe" dhe kam lidhje të ngushtë me rrënjët e mia në Prishtinë.

Unë mendoj se do të kisha qenë një person krejtësisht tjetër nëse rrënjët e mia nuk do më kishin formësuar shumë dhe jam shumë mirënjohëse për këtë.

Si e sheh botën shqiptare: traditat, doket, zakonet dhe kulturën?

- Unë, thuajse, ushqehem me traditat tona dhe historitë e lashta që janë përcjellë ndër breza. Udhëtimi në vende të tjerë për librin tim të dytë "Dinjtet dhe falje", për të parë se si diaspora atje e mbanë gjallë kulturën shqiptare, më preku thellë.

E dua kulturën tonë, por gjithashtu mendoj se kemi ende shumë për të bërë, sidomos në aspektin e feminizmit.

A krenohesh që je shqiptare ose, më saktë, cili është rasti që je ndier shumë krenare?

- Janë femrat shqiptare ato që më lënë të ndiej pjesën më të madhe të krenarisë që mbaj për origjinën time. Në librin tim të parë, "Barrë & Bekim", shkruaj se femrat shqiptare vijnë nga mbretëresha Teuta dhe në historinë tonë kjo pasqyrohet në shumë gra, e që e kanë formësuar kulturën tonë, si Shotë Galica, Nexhmije Pagarusha, Shkurte Fejza, Nënë Tereza, e shumë të tjera.

E, sidomos me kohën më të re, ku jemi bekuar me sportiste, si Majlinda Kelmendi dhe vajza të tjera të talentuara.

Sidoqoftë, jeni mirë e integruar në Zvicër, apo?

- Zvicra është bërë një shtëpi e dytë për mua dhe kam një dashuri të madhe për të brenda meje. Po të isha pemë, rrënjët e trunqut im do të ishin Kosova. Degët që shtrihen nëpër botë do të ishin Zvicra.

Dhe, mendohem t'ia kthej aq sa kam marrë nga Zvicra...

Keni studiuar për gazetari dhe komunikim. Pse ky përcaktim?

- Gazetaria më ka magjepsur gjithmonë. Përhapja e historive të njerëzve në botë dhe tregimi i asaj që po ndodh në botë më mbush edhe sot.

Mbi të gjitha, mendoj se doja të tregoja se ne, gratë, në Zvicër mund të arrijmë gjithçka dhe të jemi të suksesshme në çdo fushë.

Unë jam ende duke punuar si gazetare, por tani mund të tregoj shumë përmes librave të mi.

Si e sheh gazetarinë në Kosovë dhe a mund të na flasësh për eksperiencën tënde në këtë fushë?

- Kam dhënë disa intervista në Kosovë dhe më pëlqen shumë fakti se gratë, në veçanti, po fitojnë gjithnjë e më shumë vend në këtë fushë.

Për shembull, më pëlqen shumë emisioni i Vlera Jusufit, "E diela vlen", të cilin e ndjek me familje çdo të diel. Sidoqoftë, mendoj se kemi bërë pak si shumë gazetari komerciale viteve të fundit dhe më mundon fakti se ende nuk flasim mjaftueshëm për shëndetin mendor në media dhe, po ashtu, të drejtat e grave.

Ju njiheni edhe si shkrimtare dhe libri juaj i parë, "Barrë dhe bekim", flet për përvojën tuaj të mërgimit. Na flisni pak për fabulën e librit?

- Romani i parë ka të bëjë me personazhin kryesor, Shotën, e cila është rritur në Zvicër, por nuk është e lumtur. Ajo vendos ta plotësojë amanetin e gjyshes, e cila ëndërronte të eksploronte trojet shqiptare.

Kudo në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe në Malit të Zi, Shota takon njerëz të rinj, vende dhe pjesë të kulturës shqiptare.

Shota e përjeton kulturën shqiptare dhe gjithmonë i krahason historitë e njerëzve në vendlindje me përvojat, ndonjëherë shumë të vështira të saj gjatë jetës në Diasporë.

Ndërkohë, libri i dytë, "Dinjtet dhe falje", është vazhdimi i rrëfimit. Pse vendose ta qosh më tej?

- Sepse, kultura shqiptare nuk jetohe vetëm në Kosovë, por edhe në Zvicër dhe në shumë vende të tjera të botës.

Doja të tregoja se edhe larg vendlindjes sonë mbollëm një copëz të kulturës sonë, si farë në vendin e ri. Dhe, nga kjo rriten pemët e kulturës shqiptare në mbarë botën...

Por, në librin e dytë flitet edhe për vlerën e ndihmës psikologjike dhe çfarë ngarkesash i ngarkohen shpesh femrave shqiptare...

E shkruaj këtë për të thyer atë stigmë, sepse ne po rrisim brezin e ardhshëm të grave shqiptare që ta jetojnë jetën e tyre në një liri të re.

Cila është pika e fortë e librave tuaj?

- Historitë në librin tim vijnë nga takime reale, nga njerëz të vërtetë. Unë mendoj se ju mund ta ndjeni, vërtet, këtë ndërsa lexoni.

Pse shkruan në gjuhën gjermane?

- Shqipja është gjuha e zemrës sime, e gjerman-

ishtja është gjuha e kokës sime (qesh).

"Barrë dhe bekim" tashmë gjendet në shqip (online në mbarë botën dhe në libraritë në Kosovë).

Edhe libri i dytë do të përkthehet sivjet dhe shpresoj ta botoj kah Viti i Ri.

Cili është lexuesi i librave tuaj: ai gjerman, shqiptar, apo nuk ka ndarje nacionale në këtë aspekt?

- Kam shumë lexues shqiptarë, por edhe shumë zvicëranë e të tjerë.

Unë mendoj se shumica e njerëzve i lexojnë librat e mi, sepse nuk e njohin kulturën shqiptare dhe libri u jep atyre akses të lehtë në të.

"Shota" është, gjithashtu, një grua shumë e pazakontë. Ndjeshmëria e saj është e rrallë. Andaj, mendoj se kjo është arsyeja pse njerëzve u pëlqen të shkojnë në udhëtime (duke lexuar) me të.

Do të ketë edhe botime të tjerë?

- Aktualisht jam duke shkruar një pjesë të tretë, e cila do të jetë për femrat shqiptare. Ndoshta do të ketë një libër të ri vitin e ardhshëm.

Kush është muza jote e krijimtarisë?

- Muza ime janë njerëzit dhe muzika shqiptare. Ajo që më frymëzon më së shumti është vetë jeta, pasi është plot sfida dhe mrekulli. Ndonjëherë mendoj se historitë më gjejnë, sepse, më në fund, duan të tregohen.

Ku e sheh veten në të ardhmen?

- Mendoj se jam ende "e uritur" për jetën. Dua të shkruaj shumë histori të tjera, të zbuloj punë të reja dhe shpresoj ta krijoj familjen time.

Por, së pari, shpresoj të jemi shëndosh dhe gjithçka të dalë siç është kështu, sepse më pëlqen ta lë jetën të më befasoj.

Çfarë e bënë një grua - grua të përmbushur?

- Besoj se çdo grua përpiqet për diçka: qoftë





mëmësia, karriera, apo diçka krejt tjetër.

Besoj se të gjitha kemi ëndrra brenda nesh dhe se secila prej nesh ka fatin e vet. Ato që janë me fat dhe e kanë guximin, ta ndjekin atë intuitë dhe do ta gjejnë përmbushjen.

E, të fortë?

- Shpesh mendoj se ne e ruajmë forcën në trashëgiminë tonë ndër breza. Gjithmonë duhet të jemi të fortë si femra shqiptare. E, këtë e pamë te nënat, giyshet dhe stërgjyshet tona.

Ne jemi luanesha dhe nuk ka asnjë dyshim për këtë.

Por, shpresoj se brezi ynë do të mësojë ta shërojë dhimbjen e së kaluarës, në mënyrë që vajzat tona të gjejnë një forcë të re: një forcë që nuk vjen nga plagët e mëparshme.

Diçka që duhet thënë për ty e nuk është thënë?

- Më pëlqejnë gjërat e thjeshta në jetë dhe jam gjithmonë e lumtur kur njerëzit më afrohen dhe më flasin për librat, andaj u shkruaj gjithmonë të gjithëve që vijnë në kontakt me mua.

E, shkëmbimi me lexuesit është dhurata më e mirë për mua.

Sidoqoftë, ajo që shumë nuk e dinë: Unë jam mjeshtre në artin e përgatitjes së ëmbëlsirave. Tortat që i bëj unë, vërtet, janë të mrekulueshme!

Jeta jote përtej librave?

- Kaloj shumë kohë në natyrë. Më pëlqen të merrem me sport. Më pëlqen të ha dhe të gatuj shumë për miqtë dhe familjen.

Udhëtimi më plotëson dhe jam e mbushur me pasion e dashuri.

Mesazhi?

- Vlen për të gjitha gratë: Jeta juaj nesër mund të duket krejtësisht ndryshe. Andaj, jetoni atë në çdo fazë të qenies suaj dhe shijoni atë.

Plotësoni dëshirat tuaja.

Jetoni ëndrrat tuaja.

Nuk ka rëndësi sa vjeç jeni

- kurrë nuk është vonë: jeta është shumë e gjatë për të mos e jetuar ashtu siç dëshironi të jetë.

Nderim Neziri



allure.
BEAUTY

A E DI SA KUSHTOJNË
50 JAMBER?
PO **100?**

Ç'RËNDËSI KA?!
TI DO I PËRFITOSH
NGA 20 DERI MË 30 QERSHOR
PËR VETËM

€1,000

TË GJITHË JAMBER QË TË NEVOJITEN

CAKTO DATËN TËNDE.

+355 69 211 1919

@allurebeauty

Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë

Kush janë "kazanovat" e Kosovës?

Tradhtia konsiderohet shkatërruese për një marrëdhënie dhe, zakonisht, çon në ndarje. Edhe nëse pas kësaj nuk vjen fundi i lidhjes, ekuilibrat kanë ndryshuar, patjetër. E marrëdhënia tashmë do të formohet në baza të reja...

Në pyetjen: "Pse tradhtuat partnerin tuaj?", shumica e të anketuarve thonë se tradhtuan nga kureshtja, nga lakmia për të pasur një përvojë ndryshe seksuale, nga hakmarrja ndaj partneres, por edhe nga interesi personal.

VIRTYTI, 40 VJEÇ, PSIKOLOG

Virtyti është 40 vjeç. Punon psikolog. Lidhja e tij përfundoi për shkak të tradhtisë, sepse në aspektin profesional i interesonte

se si është të tradhtosh. "Marrëdhënia me dashnoren time ishte e mirë, por gjithmonë kam dashur ta provoj seksin me një femër tjetër. Dhe, rashë në lidhje me një vajzë që më tërhiqte seksualisht".

ENVERI, 71 VJEÇ: TRADHTOVA PËR T'U HAKMARRË!

"Kjo ka ndodhur shumë kohë më parë. Kam tradhtuar për t'iu hakmarrë gruas sime, meqë në kohën kur isha me punë në Libi, ku qëndrova dy vjet në vitet 90, dëgjova nga një mik imi se ime grua në atë kohë e kishte pasur një frajer", thotë Enveri, tash 71 vjeç, nga Prishtina.

ASIMI, 59 VJEÇ: KAM TRADHTUAR NGA KURESHTJA!

Asimi, nga Fushë-Kosova, tash 59 vjeç, tregon se para 9 vjetësh e kishte tradhtuar gruan e tij me kolegen e punës, mësuese në të njëjtën shkollë ku punonte edhe ai. "Më pëlqente të veçohesha nga të tjerët, edhe pse me grua i kisha punët fort mirë dhe e di se më donte pa hile. Por, afria që kisha me kolegen time të shkollës bëri që një pasdite të shkonim për kafe e përfundam në banesën e saj.

Por, kur u ktheva në mbrëmje në shtëpi isha shumë i skuqur në fytyrë dhe grua ja ime e vërejti këtë gjë, por, për çudi, nuk ma bëri asnjë pyetje. E, kjo ndikoi që më asnjëherë të mos jem me kolegen time në banesën e saj".

ISMETI, SHITËS, NGA PRISHTINA, 69 VJEÇ: TRADHTIA MË DHA FUQI SE ISHA DIKUSHI!

"Edhe tash habitem me veten time pse e tradhtova gruan me punëtoren që punonte në marketin tim. E, ç'është më e keqja, pas atij rasti punëtorja ime u dashurua në mua dhe kërkonte që në depon që e kisha në bodrum të bënim seks edhe herë të tjera, por një herë gabova dhe i dhashë fund me aq. Natyrisht, më pëlqente të isha i pëlqyer nga një vajzë e re siç ishte shitësja ime, e tradhtia më dha fuqi se isha dikushil"

PËR FUND

Këto janë disa nga përjetimet e "kazanovave" tanë, të cilët nuk ngurrojnë të flasin për një periudhë me furtuna të forta në jetën e tyre, e që u ka dhënë mend të ndalen dhe të mos i shkatërrojnë familjet e tyre...

Selim Rama



Ass. Prof. Dr. **Berk Arapi**

Specialist i Kirurgjisë Vaskulare

30 QERSHOR - 2 KORRIK

LARGIMI I VENAVE VARIKOZE PA NDËRHRYJE KIRURGJIKE

LARGIMI I VENAVE ME LASER

Procedurë që zgjatë vetëm **40 min** dhe kryhet nën anestezion lokal. Menjëherë pas procedurës ju liroheni për në shtëpi dhe vazhdoni aktivitetet normale





SHQIPTARI IA FTOHË AJNSHTAJNIT!

Një shqiptar e kishte takuar Ajnshtajnin në kupenë e një treni. Ajnshtajni i tregonte diçka, e shqiptari i ndërhyri për ta gjunjëzuar kinse ishte më i dijshtëm.

“Zoti Ajnshtajn, në çfarë gjendje del ajri nga goja?”, e pyeti ai.

“Në gjendje të ftohët”, i tha ai.

“E, pse njerëzit i ngrohin duart me ajrin që del nga goja?!”, i thotë shqiptari.

LOPA MILEJ ME DEF!

Një lopë e tregonin të sertë. E akuzonin se nuk mund ta milje lehtë, sepse nuk linte ta milje nga shqelmat.

Sidoqoftë, një njeri vendos ta blej, pavarësisht problemeve lidhur me mjeljen.

Por, blerësi kishte qenë i mençur dhe merr defin e i bie, kurse gruaja e tij e mjelë lopën.

Pra, defi e qetësoi lopën dhe, kështu, ia gjet ilaçin...

SECILI SHQIPTAR I DI 5-6 GJUHË!

Shkon një shqiptar i Kosovës në Amerikë. E pyet një amerikan sa gjuhë i dinte. I tha se i dinte disa gjuhë.

“Cilat?”, e pyeti.

Ai nisi t’i numëronte...

“Di të flas jerm, të flas vetmevete, të flas pas shpine, të përgoj, të flas me ton të lartë, por edhe jangra-jungra”.

“Ç’gjuhë është kjo e fundit?”, e pyet.

“Jangra-jungra është gjuhë që as unë s’e kuptoj!”, ia kthen ai.

Sokol Murturi

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhje
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në Info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de



Pas mëkateve, si ta nisi një jetë të re?

Jam 31-vjeçare, por në pamje dukem si një 25 vjeçe apo edhe shumë më e re.

Megjithatë, kam një hall të madh... Jam shtatzënë në muajin e shtyrë të shtatzënisë, ku nuk mund të bëhet aborti dhe po ndihem keq prej familjes.

Shtatzënia ka ndodhur falë bashkëjetesës me një person, që prisja të shkoj çdo gjë si më së miri me të... Por, jam zhgënjyer shumë dhe jam e dëshpëruar nga jeta.

Megjithatë, po pres të filloj një jetë të re dhe t'i harroj gjërat e ndodhura. Jam e penduar dhe dua që Zoti t'mi

fal mëkatet që i kam bërë. Kërkoj këshillë nga Redaksia..

Fatlumja

Nëse mendon për historinë e këtij problemi, është vonë dhe reagimi i vonuar ka bërë që gjërat të vështirësohen deri te pendimi. Shtatzënia me njeriun me të cilin ke bashkëjetuar e të ka krijuar probleme në familje, megjithatë gjërat janë aty ku janë dhe nuk ja vlen të mendosh shumë se si ka ndodhur çdo gjë.

Fëmija është fëmijë, pa marrë parasysh se kush është babai i tij. Ajo që është me rëndësi tash - mos

kalo në depresion, sepse do bëhesh nënë dhe do të të fillojnë preokupime të reja, të cilat do të të qojnë me vëmendje kah fëmija.

Në këtë mënyrë, jeta jote do të ndryshojë shumë, sepse gjërat do t'i shikosh nga këndi i nënës, pa marrë parasysh nëse do ta mbash apo do ta japësh fëmijën.

Megjithatë, do të vijnë ditët kur do të qeshesh dhe kjo jetë stresi do të të kalojë dhe do të ndihesh stabile në jetë, sepse njeriu mësohet me çdo gjë.

Në fund të fundit, të jesh nënë është kënaqësi.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

Në vendin e punës...



E divorcuara...

Sheqer-gjyshja del në takim me djem 30 vjeç!

Edhe pse jam 58 vjeçe, dal në takim vetëm me djem deri në 30 vjeç. Ata me donë dhe më thonë se jam sheqer gjyshe...

Jam 58 vjeçe, e divorcuar nga burri. Por, meqë kam fëmijë, për hir të fëmijëve nuk i kam ndërprerë krejtësisht raportet me burrë, sepse kam nevojë nga ish-burri për përkrahje materiale. Sidoqoftë, jam shumë e lumtur që jam divorcuar, sepse jeta e martuar nuk ka qenë për mua zgjedhja e duhur: përlarje me burrë çdo ditë...

Sidoqoftë, një kohë pas ndarjes e kalova në vetmi, sepse nuk e kam ditur se kishte djem që donë të dalin me gra si unë, si gjyshja e tyre, si sheqer gjyshja nëse mund të them kështu.

Andaj, jam e lumtur, sepse ha kur dua, pi kur dua dhe i bëj të gjitha zgjedhjet në jetë sipas qejfit tim dhe nuk e kam askënd që t'më përzihet apo t'më tregoj se çfarë duhet të beja a të mos bëj.

Dhe, prej se kam vendosur të jem e divorcuar, më donë shumë burrat që i kam në fqinjësi dhe më thonë se jam femër ideale për të kaluar kohën, sepse fëmijët tashmë janë rritur dhe nuk janë të varur nga unë.

E, pse po i bëj këto gjëra?

Sepse shpirtin e kam ende të ri. Me shpirt ndihem si kur kam qenë 20 vjeçe dhe po e ndjej veten ashtu...

Vahidja, Ferizaj

Shefi po më prek ku s'duhet!

Shefi po më prek ku s'duhet, por mu po më kënaq. Tash e di se do bëhem menaxhere...

Jam 29 vjeçare, e pamartuar, jetoj në Zvicër. Pas përfundimit të studimeve fillova të punoj në një firmë të një të njohuri tim. Në fillim u punësova si masazhere, por me kalimin e kohës shefi më avancoi dhe paga ime m'i plotësonte nevojat e mia jetësore.

Por, ç'është e keqja, dalëngadalë filloi t'më pëlqente shefi dhe fillova të dashurohesha në të, përkundër faktit se është i martuar dhe i ka dy fëmijë. Dhe, gjithçka mori fuqi kur një ditë, në zërrën time erdhi ai dhe kërkoi t'ia kryeja një punë.

Mirëpo, teksa bisedonin për punën

që duhej bërë, nisi t'më prekte aty ku s'duhet.

Megjithatë, më pëlqeu prekja e tij, sidomos kur e dija se unë s'isha e virgjër, meqë kam qenë e fejuar me një djalë pesë vjet, por u ndamë shkaku i xhelozisë së tij të tepruar.

Dhe, një ditë tjetër, kur erdhi po ashtu për punë, dora e tij rrëshqiti mu aty ku s'duhet dhe m'u errën sytë dhe e putha.

Por, ai nuk u ndal vetëm me një puthje timen. E mbylli derën nga brenda me çelës dhe filloi t'më desh ngadalë e me ledhatime të lehta dhe përfundam në shtrat.

Mirëpo, meqë është burrë i sigurtë, më tha troç: "Ishte çka ishte, më nuk do përsëritet, sepse nuk ndahem nga gruaja!".

Por, një gjë e tillë më pëlqente edhe mua, meqë nuk isha e interesuar për martesë, por për avancim në punë.

Fikrija, Cyrih

Jetë me halle...

Biznesmeni:

Po më vjen inati prej dashnores që më ka lëshuar takati!

Shumë njerëz sot janë në hall me grat e tyre të reja, por edhe me dashnoret. Dhe, nga inati që mendojnë se ende janë të formë, "shpëtimin" e gjejnë në barnatore, duke kërkuar stimules...

"Po më duket se kohëve të fundit më ka lëshuar takati", këto fjalë i dëgjova na një burrë rreth të 60-ave, i cili në kafene, teksa pinte kafe, bisedonte me një burrë tjetër.

"Pasha Zotin", vazhdon tutje ai, "po më vjen inati më shumë nga dashnorja sesa nga gruaja që s'po muj me i krye mirë "detyrat e shtëpisë", siç thuhet në popull".

NJËMIJË GJËRA PËR NJË PROBLEM...

Dhe, pas këtyre fjalëve, seç më sillen në mendje një mijë gjëra, e që lidhen me këtë problem.

Një, se femrat e sotme nuk janë si përpara dhe se shumica e tyre sot për sot kërkojnë vetëm kënaqësi, e të mos flas për dashnoret që shart të parë e kanë kënaqësinë, e pastaj vijnë të tjerat, si, bie fjala, shëtitjet luksoze dhe veshjet e shtrenjta, e të tjera të ngjashme.

Por, për t'u ofruar kënaqësi seksuale

gruas dhe dashnores kjo forcë e energji shumëkujt po i mungon, në radhë të parë kur dihet se mu ata që kanë grua dhe dashnore, njëkohësisht, kanë edhe obligime biznesi, sepse fukaraja, siç dihet, nuk mund ta mbajë as gruan e vet e lëre më të huajën...

Andaj, për ta, pra për ata që kanë nevojë për viagra, është e nevojshme që t'i gjejnë ato ku janë e ku s'janë, në mënyrë që ta tregojnë vetveten se ende ndihen në formë.

Megjithatë, të njëjtit harrojnë se viagrat kanë edhe kundërefekt, sepse ndryshe nuk mund të komentohen rastet e të moshuarve që po vdesin papritmas në motele, siç na ka rënë të dëgjojmë e lexojmë shpesh në portalet tona.

Diturie Haxhaj

Anketë me të moshuar...

Si ishin aventurat e gjyshërve e gjysheve tona?

Brezi i dikurshëm i njerëzve, e sidomos i gjyshërve tanë, kanë jetuar krejt ndryshe, në krahasim me jetën që bëjmë tash ne, "brezi i Republikës", siç thoshte Ibrahim Rugova.

Andaj, në këtë anketë disa nga të moshuarit shprehin mendimet e tyre për kohën kur ishin të rinj...



MUSA, 71 VJEÇ: PO T'MIRË T'PASKA FALË ZOTI!

- Po, edhe ne e kemi ditur se çka është mirë, por nuk kishim kushte. Por, edhe pse na dilte shpirti në ara e në livadhe, kur e shihnim nga larg të vinte ndonjë grua e mirë, i hapnim sytë sa grushti!
E, kur mujshim me fol me te, fjalët e para ishin: "Po t'mirë t'paska fal Zoti!"
Por, tash djemtë e sodit janë më të mirë. Se, pasha Zotin, me pas kanë kjo cul-lakhane në kohën tonë, nashta ishim vra ndërmyet veti se cili po e ze rendin i pari...

HAVUSHJA, 73 VJEÇE: DEMUSHI S'PAT LËNË GJË PA BËRË PËR ME MË MARRË MUA GRUA!

- Kur isha 16 vjeçe, një ditë vere, teksa ua dërgoja punëtorëve bukën në ara, një Demushi që e kishte shtëpinë në fund të katundit, më doli para dhe më ndali, bile më rrokua edhe për krahu...
I thashë, mos se na shohin. Por, as që e pat gajle për atë punë...
Më tha se nuk e merr gjumi tu mendua në mua, se nuk sheh femër tjetër veç meje, se...
E unë, e turpshme siç isha, i thashë - al-

lahile largohu se po na pa aga (vëllai i madh), Zoti e di si përfundon kjo punë. Por, as kjo rixha nuk bëri punë. Nuk ma lëshonte dorën dhe si vetëtimja më puthi në faqe.
U dridha, më lëshuan këmbët, gati u rrezova në tokë...
Por, pas nja 6 muajsh mua më fejuan në një fshat të komunës sonë, në Dramjak të Ferizajt dhe më nuk më linin të dilja jashtë oborrit të shtëpisë pa më përcjellë dikush nga familja.
Ai, Demushi, më pat qua fjalë për çikën e mixhës së tij se është i gatshëm t'më grabisë, por, edhe pse filloi t'më pëlqej, nuk doja t'ua merrja fytyrën familjes, sepse në atë kohë ikja e çikës nga shtëpia shpeshherë përfundonte edhe më vrasje.

SELIMI, 77 VJEÇ, NGA VUSHTRRIA: PREJ OBORRIT TË SAJ MA BËRI ME DORË!

- Nuk kemi vrapu veç ne, mashkujt, mas vajzave. Tri shtëpi larg shtëpisë sime ishte Dinorja. Sa herë që kaloja rreth oborrit të saj e shihja në oborr: ose t'u punu, ose t'u u qit pulave kollomoq.
Ishte e shtunë kur dola nga shtëpia për të shkuar në shehër. Ajo ish kanë në oborr.

Kur më pa shpejt e shpejt ma bëri me dorë. Por, edhe unë ia bana, edhe pse m'u dridh zemra fort.
Në ato çaste ia bëra më dorë që të vinte në qytet, por ma bëri me gishtin tregues jo. Rugës deri në qendër të qytetit më dukej sikur fluturoja. Më kapi një segelldi...
Por, deshi Zoti dhe një javë më vonë e pash në shehër me një vajzë të vogël për dore. U ndal, më foli dhe ma shtrëngoi dorën fort.
Shtrëngimi i dorës ishte shenjë se më donte. E, në ato çaste, e rroka edhe një herë për dore dhe ia shtrëngova edhe unë dorën shumë. Kështu, ia bëra me dije se e doja...
Dhe, ditë pas ditësh më çoi fjalë se dëshironte të fejohej me mua. Fluturova nga gëzimi. I tregova babës dhe pas nja dy javë mësit e çuam dajën e saj.
Në tetor të vitit 1970, kur isha 24 vjeç e ajo 20, u martuam dhe deshi Zoti e të dy hala jemi gjallë.

PËRFUNDIM

Çdo kohë dhe çdo brez i ka përjetimet e veta, kush më shumë e kush më pak. Por, edhe në kohën për të cilën bëmë fjalë ka pasur dashuri e simpati, ani pse jo haptazi si tash.


Diturie Haxhaj

KEN DA

CENTER

BY SHKENDA DUBOVA

KEN DA
CENTER
BY SHKENDA DUBOVA



kendacenter.al

KEN DA
CENTER
BY SHKENDA DUBOVA

SHENJAT E MUNGESES se magnezit.

- ✓ Dhimbje koke, lodhje /jo energji.
- ✓ Dhimbje muskujsh , mungesë për qëndrim.
- ✓ Rrahje të çrregullta zemre.

KEN DA
CENTER
BY SHKENDA DUBOVA

SHENJAT E MUNGESES së vitaminës C.

- ✓ Humbje peshe, anemi.
- ✓ Dobësi dhe nervozizëm.
- ✓ Dhimbje muskujsh dhe dhimbje artikulationesh.

KEN DA
CENTER
BY SHKENDA DUBOVA

SHENJAT E MUNGESES së vitaminës D

- ✓ Lodhje dhe humbje oreksi.
- ✓ Dhimbje kockash , rënie flokësh.
- ✓ Depresion , ndjenjë mërzie.

kendacenter.com

Pse ia bëj qejfin vetit?!

Jam njeri i vakive. Shoh ëndrra se jam i lumtur, a në shpirt e kam një zbrazësi për një person që ka qenë në jetën time rrafsh 11 vjet e më nuk është...

Atë ditë që kisha parë ëndërr kinse jam i lumtur, do të thërriste një e re në telefon dhe do bënim një takim gjysmë pune, në të cilin do të kishte gjithçka nga pak.

Por, mendoja me vete se do të ndodhte diçka që do ma prishte lumturinë...

Ishte gati mesditë kur telefoni hodhi "flakë".

Mirëpo, nuk zgjati as dhjetë minuta dhe thirrja tjetër flakëroi monitorin e telefonit tim.

Do të vinte edhe një e re tjetër për çështje krejtësisht pune. Në atë mo-

ment i thashë kolegut tim se isha i pafat. Njëra thirrje e prishi tjetrën dhe i refuzova takimet e ditës, meqë nuk do më linin rehat thirrjet të pija kafënë e ditës.

SHOH ËNDRRA KINSE JAM I LUMTUR!

la kishte dhënë ferku i mëngjesit kur më kaploi dëshpërimi. Ishte një gjysmë kllapie gjumi dhe mendoja pse më ishte shfaqur ëndrra e lumturisë së rreme.

Djersët në ballë vazhdonin të binin në çarçafin e bardhë të shtratit. Në fakt, ishte një arsye që më kishte gënjyer atë natë lumturia.

Ngrita kokën sikur doja të testoja shëndetin nëse mund ta ngritja kokën apo jo.

Ngrita kokën dhe pash unazën time afër kokës, paksa e fshehur nën jastëk. Nuk më kujtohej se e kisha hequr nga gishti...

Nuk është unazë fati, nuk është as unazë lumturie. Nuk është as unazë zemre. Është unazë dyngjyrëshe. Në

dy fusha bardhë e zi ka nga një pikë. Në fushën e bardhë është një pikë e zezë, e në fushën e zezë një pikë e bardhë.

Ashtu sikur realiteti i kësaj nate - prisja të gëzohesha dhe u dëshpërova! Me të parë unazën e enigmës jetësore u zbutën ndjenjat e hidhërimit. Sytë më shkuan në fushën e zezë, që do të thotë se kur të jesh në një dëshpërim, sikur isha unë tani, është një dalje drite.

Është pika e bardhë në fushën e zezë, e cila sinjalizon të dëshpëruarin se jo gjithnjë do të ketë dëshpërim.

Jo gjithnjë do të jetë i mbuluar nga pikëllimi.

Jo gjithnjë do jesh i zhgënjyer.

Jo gjithnjë do jesh i frustruar.

Duhej ta fshija lotin, sepse në fushë të zezë është një pikë e bardhë që tregon dritë në fund të tunelit.

E, nata e ka dritën e mëngjesit...

Do të agojë dita dhe nuk do ketë frikë njeriu.

Nuk do të ketë as ankth dhe mund të ndihet i tëri i lumtur.

S. Murturi

A fitohet mirë nga mesitnia?

Në Podujevë jeton një njeri që thuhet se e ka dorën e hajrit. Nuk është i çuditshëm vetëm për nga jeta e stili që ka bërë në ofrimin e femrave dhe meshkujve që kërkojnë të njihen dhe martohen, por edhe për nga emri. Quhet Xhezali Hashimi.

Xhezali Hashimi i ka nëntë fëmijë. Ai ka pasaportë zvicerane, ku edhe ka punuar dhe ku vazhdon t'i këtë fëmijët atje. Shkon nga disa muaj në Zvicër dhe prapë kthehet në Kosovë. Prioritet jetësor i ka dy gjëra: namazin në xhami dhe mesitninë.

SI E NISI PUNËN E MESITNISË?

Punën e mesitnisë e ka nisur në moshën 17 vjeç. Në atë kohë kishte pas shkuar te daja dhe kur kishin rënë për të fjetur i kishte thënë dajës: "O dajë, nuk më pyete pse kam ardhur!". "Nuk është adet me pyet pse ke ardhur, por me hajër për çka do që ke ardhur", ia kishte kthyer daja. "Dajë, kam ardhur mesit për vajzën

tëndë!", i kishte thënë dhe kishte vazhduar: "Po e kërkoj për dajën tjetër!". Dhe, për të mos u çuditur, babai i tij i kishte pasur dy gra dhe të dy palët i quante dajë... Ai ka punuar 30 vjet mjeshtër qeramike nëpër shtëpia dhe ka fituar besimin e njerëzve. Andaj, nëse je i besueshëm, ta besojnë edhe vajzën e edhe djalin.

...MBI 500 MESITNI

Ai gjatë punës mesit ka arritur t'i ketë bërë mbi 500 mesitni, 400 prej të cilave i ka shënuar me datë në fletoren e shënimeve. Mesitni ka bërë në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, por besa edhe jashtë shtetit, sidomos në Zvicër. Ai, kur i paraqitet dikush se kërkon nuse a burrë, analizon, për shembull,

moshën e vajzës që t'i përshtatet rangut dhe i takon. Edhe vajza e edhe djali duhet të shkojnë në takim in e parë me prindërit e tyre. Ata flasin, bisedojnë, kuptohen dhe pastaj shihen vetë dhe vendosin nëse do të martohen apo jo... Por, ka ndodhur që puna edhe të priset... Sidoqoftë, nuk ka çmim të caktuar për askënd. Thjesht, secili çka premtion dhe jep vetë. Ka raste që ku janë takuar një vajzë me një djalë, mashkulli e ka pyetur: "A ke pasur dikë?". Ajo i ka thënë: "Sa kam pasur meshkuj nuk kam gishta në dorë, por që nga momenti që të martohemi më nuk kam me pasur tjetër pos teje". Dhe, janë martuar...

S. M.



Ndodhi e rrallë te shqiptarët

Tre vëllezër e donin të njëjtën grua!

Ishin zënë ndërmjet veti tre vëllezër për një nuse në Prishtinë. Nusja ishte grua e vëllait më të madh, por i dyti e i treti kishin menduar se nusja që u erdhi në shtëpi është e të gjithëve. Kështu kishte plasur sherri në shtëpi, derisa i pari i shtëpisë, vëllai i madh, e kishte kapur një hu gardhi dhe u kishte hy dru...

Pse kishte ndodhur kështu?

Kur vjen nusja në shtëpi, vëllai i madh, meqë ishte martuar me të, shkon në dhomë me fjet me të.

Por, në natën e dytë, kur vjen koha të flinin, fillon sherri, sepse i dyti vëlla mendon se tash e kishte radhën të fle ai me nusen që e kishin në shtëpi. Ai e kapë për fyti të parin, duke i thënë:

"Ti ishe mbrëmë me nusen në dhomë, tash e kam radhën unë!".
"Çfarë radhe, ore?! Kjo është nusja ime dhe vetëm me mua do fle!
Merre edhe ti një nuse dhe nuk ta merr kush!", ia kthen ai.

S.



Pse kam nostalgji për atë që nuk kthehet më?!

Pas shumë vitesh u shtriva në oborrin e vjetër të shtëpisë. Zogjtë këndonin këngën e pranverës, që ma zgjonte një idilë jetësore. Ishte natë më hënë të plotë, e që ma kujtoi fëmijërinë.

E shikoja hënën dhe mendja thellohej te ajo. Nisa t'i flas hënës, t'i them se si nuk je mplakur fare. Je po ajo që ke qenë në kohën e fëmijërisë sime, kur shfaqeshe mbi kodrën e sotme, kodër e cila tash nuk e ka pamjen e dikurshme, sepse mihësit e pandërgjegjshëm e kanë shkatërruar. Në atë kohë, unë, fëmija i miliona ëndrrave bija në konflikt me babanë për ty, duke kërkuar prej tij të më merrte me vete në majën e kodrës së Surgjukut. Por, sa herë që pritonte babai që të shkonim në majën e Surgjukut, më thoshte se sot atje ka ujç...

Andaj, kam nostalgji për atë që ka kaluar, për atë që nuk kthehet më... Por, kujtimet janë pjesë e të jetuarit, pjesë e një jete. Prandaj, nuk është ndonjë gabim të jetohet me kujtimet e të kaluarës...

S.

Astrologji

Ç'thotë astrologia Meri Shehu për martesën e Luizit me Kiarën?



Edhe pse dashuria e Luizit dhe Kiarës për katër muaj i tregoi popullit se si nis dhe zhvillohet një ndjenjë, astrologia e njohur, Meri Shehu, thotë se martesa e Kiarës dhe Luizit është e reme.

Astrologia e njohur thotë se shkak i Mërkurit kundër, marrëdhënia e tyre mund të jetë në rrezik dhe të përbal-

let me probleme.

Kiara në Horoskop është Bricjap, andaj Bricjapët do merren shumë me dashurinë, me fejesa e martesa. E kjo ndodhi edhe me Kiarën. Ajo u martua. Por, me Merkur të kundërt do të ketë probleme. Me Mërkur të kundërt nuk merren vendime, nuk bëhen kontrata.



Kompleksi Cima 2

Rr. Mati 1, Prishtinë



Lagja Eliza

Rr. Hamdi Grajqevci, Fushë Kosovë



Kompleksi Dardania

Lagja Dardania, Prizren



www.cimaks.com

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Ka përfunduar gjithçka, por nuk po mundem pa të!

Jam burrë i martuar. Në rini e kam dashur një vajzë, e cila tani është bërë zonjë. Koha ka shkuar, por unë nuk mundem ta harrojë, apo, të paktën, nuk mund ta përballoj pa folur me të... Familja më kanë penguar të jem me të, megjithatë e dua shumë dhe e di se ende e dashuroj...

“Pa shifër”

Përgjigje:

Nuk duhet të jetoni me ëndrrat rinore! Koha ka kaluar dhe nuk është në dobinë tuaj sa i përket asaj që, gjithash-tu, ka familje.

Me kohë është dashur të bëhet çdo gjë, andaj ka ekzistuar dukuria e ikjes së vajzave kur i kanë marrë për gra meshkujt që nuk kanë mundur pa to.

E, ti nuk e ke shfrytëzuar të drejtën tënde për të krijuar jetën me atë që e ke dashur, ndaj tash nuk ia vlen të shkaktosh më shumë prob-

leme për një gjë që nuk u takon më.

Dhe, nëse vazhdon kështu, shoh se mund të zbulohet i tërë problemi dhe hyni në rrugë pa dalje.

Andaj, kthehu në jetën tënde, sepse është vonë ta kthesh kohën e shkuar!

Ç’qëllim ka ish-i dashuri im?

Jam vajzë 27-vjeçare, jetoj në një fshat të rrethinës së Ferizajt.

Kam pasur një të dashur, me të cilin kemi qenë së bashku 7 vjet, por ai u martua.

Ndërkohë, ai shkoi jashtë dhe i ka bërë letrat nga gruaja e tij.

Megjithatë, mu ka lajmëruar përsëri dhe më ka ofruar martesë, duke më premtuar besnikëri.

Jam pa tekst! Jam e humbur prej kur ma ka thënë këtë gjë dhe nuk di t’i besoj a jo...

Çka më këshillon?

“E humbura”

Përgjigje:

Kam mendim negativ sa i përket ribashkimit tuaj me martesë.

Këshilla ime është ta gjesh fatin e ri, sepse mund të ndodhin shumë gjëra të pakëndshme nëse ju lidheni përsëri.

E para, ribashkimi juaj me martesë do të qonte në ndarjen e tij nga gruaja, e cila ia ka bërë letrat për qëndrim;

E dyta, është problem, pastaj, t’i mbetën letrat atij.

E treta, çrregullimi ndër-familjar mund të prodhojë krejt situata të reja...

Andaj, kërkoje fatin e ri dhe harroje atë person, sepse në kohën e duhur nuk të ka bërë zgjidhje, andaj nuk e ke të sigurt se as tani do të të bëjë zgjidhje fatlume...

Pse nuk më duan njerëzit?

Zonja magjistare, të shkruaj nga Luksemburgu. Jam 38-vjeçare, nënë e dy fëmijëve.

Me burrë jam ndarë para dy vjetësh dhe vazhdoj të punoj e t’i rrisë fëmijët vetë.

Por, kam një hall: Të gjithë ikin prej meje! Nuk më ofrohet askush, edhe pse unë nuk u bëj keq...

Kjo po më dhemb në shpirt, sepse nuk po kam me kë të shpreh asnjë brengë...

Ç’të bëj që ta rifitoj rrethin tim ku ka edhe shqiptarë shumë?

“Vejusha”

Përgjigje:

Ti jeton në një vend të vogël, ku çdo gjë merret vesh shpejt. Ke pasur lidhje me një person, banor i atjeshëm dhe kanë dalë fjalë për ty... Andaj, kjo ka bërë që rrethi të të shmanget, por edhe familja e burrit po bën propagandë të madhe që të të largohen njerëzit prej teje. Sugjerimi im është të sillësh mirë me njerëzit kudo që je dhe të jesh nënë e edukatore e mirë, e pastaj gjërat do të shihen vetvetiu dhe rrethi yt do të rikthehet përsëri...

Si e sheh të ardhmen time: Me burrë apo e ndarë?

Jam zonjë, 38-vjeçare, jetoj në Prishtinë.

Një kohë kam jetuar në Francë, por nuk kam mundur të bëj jetë atje, andaj jam kthyer në vendlindje. Jam martuar në vitin 2019. Dua të di si do ta kem jetën time dhe, nëse ka mundësi, t'më thoni diç për të kaluarën time se ku kam gabuar që nuk më shkoi mirë jeta në kurbet?

“Miradija”

Përgjigje:

Nuk të shoh pranë burrit me të cilin jeton. Sepse, je martuar me të pa e shëruar plagën nga ndarja me burrin me të cilin ke jetuar në Francë. Prandaj, gabimi qëndron

mu aty se, të paktën, edhe dy vjet nuk është dashur të kishit bërë martesë. Sepse, të martohesh me një burrë, duke vuajtur për tjetrin me të cilin ke jetuar, është krim dhe nuk të bën të lumtur as ty e as burrin. Andaj, së shpejti do të ndaheni...

Tri pyetje për tri probleme

E nderuara magjistare, i kam 3 pyetje për të cilat po kërkoj përgjigjen tuaj.

1. Si e parashikon të ardhmen e familjes sonë gjashtë anëtarësh?
2. E kemi hapur një lokal dhe në fillim kishte punë, por pastaj ra përnjëherë puna. Pse?
3. Meqë jemi në pranverë, si të mbrohem nga magjitë? (Këtë pyetje po ua bëj për faktin se çdo herë gjejmë gjëra të ndryshme në prag të derës dhe e di se ato nuk janë për të mirë aty).

“Sebi”

Përgjigje:

Një familje gjashtë anëtarësh ka fuqi pune dhe menaxhimi për të punuar në mënyrë solide. Kjo është baza e ekonomisë familjare, pra faktorin njeri e keni. Kjo është më e mira që mund të keni. E, sa do të ngrihet ky kapacitet njerëzor për të bërë ekonomi të mirë familjare,

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

kjo varet nga interesimi. Hapja e lokalit afarist, që nuk po e paragjykoj se çka ka qenë, nëse në fillim të punës ka filluar me sado pak sukses, e nëse tash është mbyllur, kjo tregon se nuk e keni menaxhuar mirë, apo dikush e ka bllokuar suksesin tuaj përmes mënyrave konspirative, e që sot është duke ndodhur.

Nëse në një provincë hap dikush lokal, e afër tij hapet një market i madh, atëherë ata organizojnë dëmin për palën tjetër. Kjo është konkurrenca. Pra, tregu i konkurrencës hetohet në çdo biznes sado i vogël që është.

Pyetja e tretë mund të merr përgjigjen se në pragun e derës ju, me siguri, nuk leni gjëra të dyshimta, por ato i lë dikush aty, në shtëpinë tuaj. E, çdo send i dyshimtë nuk është i mirë dhe zgjon dyshim, e dyshimet mund të qojnë edhe në magji të ndryshme.

Andaj, ruajuni nga magjitë, sepse me ditët e pranverës, sidomos ato para dhe pas Shëngjergjit, janë ditë kur edhe gjejnë shtrirje dhe ndikim më të madh.

PRIME TOURS & TRAVEL.



BILETAT MË TË VOLITSHME NË ÇDO CEP TË GLOBIT!

REZERVONI TANI DHE PËRFITONI VETËM ME PRIME!



PRIMETRAVEL
Smile



SCAN
ME



SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

SHERWOOD
exclusive kemer

SHERWOOD
exclusive Lara

SHERWOOD
Dreams Resort

TUI BLUE
Belek

SHERWOOD
Premio Hotel

GREENWOOD
Kemer Resort

GREENWOOD
Suites Resort

www.sherwoodhotels.com.tr